

SHENIME SPJEGUESE
P E R
PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISEZENIT & CO SHPK, TIRANE
Ushtrimi i mbyllur me 31.12. 2021

A - Informacion i përgjithshëm

A I - Kuadri kontabel i aplikuar

Kontabiliteti ne pergjithesi eshte organizuar dhe mbajtur ne pajtim me kerkesat e ligjit Nr. 25/2018 date 10.5.2018 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Pasqyrat financiare te shoqerise per vitin 2021 jane pergatitur ne baze te Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara, shpallur nga Ministri i Financave.

I gjithë dokumentacioni financiar dhe kontabel i veprimtarise se shoqerise perpunohet dhe regjistrohet nga sektori i finances ne menyre kronologjike. Veprimet kontabile jane mbeshtetur ne dokumente justifikuese, vertetuese dhe te datuara, duke u plotesuar ne perputhje me kerkesat ligjore ne fuqi.

A II - Pershkrimi i politikave kontabile te perdorura ne pasqyrat financiare

Vleresimi i aktiveve materiale afatgjata eshte bere ne baze te koston historike te korigjuar me amortizimin e llogaritur.

Amortizimi eshte llogaritur dhe evidentuar ne menyre analitike per cdo grup te aktiveve te qendrueshme, sipas menyrave dhe normave te percaktuara me Ligjin Nr. 8438 date 28.12.1998 “ Per tatimin mbi te ardhurat “ i ndryshuar.

Inventaret vleresohen me koston e blerjes.

Transaksionet e kryera ne valute gjate vitit jane konvertuar ne leke me kursin e dites se kryerjes se transaksionit. Gjendjet ne valute me 31.12.2021 jane konvertuar ne leke me kursin e Bankes Shtetit per kete date dhe diferencat e konstatuara jane regjistruar per neto ne rezultatin financiar te ushtrimit.

Detyrimet per shtetin per tatimet dhe per sigurimet shoqerore jane percaktuar ne perputhje me dispozitat ne fuqi.

Pasqyrat financiare jane plotesuar duke respektuar parimet themelore te kontabilitetit si :

- Vijimesia e veprimtarise se shoqerise
- Moskompesimi i posteve te bilancit
- Kuptueshmeria e pasqyrave financiare
- Rendesia dhe materialiteti.
- Besueshmeria dhe besnikeria dhe sinqeriteti i paraqitjes se te dhenave
- Qendrueshmeria e politikave kontabile dhe krahasueshmeria
- Parimi i perparemise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore.
- Paprekshmeria e bilancit te celjes.

B - Informacion – shtese mbi zerat materiale te paraqitur ne pasqyrat financiare

B1- AKTIVET

B1.1. - Aktivet afatshkurtera

i.- Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare prej 58,477,433 lek me 31.12.2021
perbehet nga :

- Gjendjet ne banka 58,255,034 lek
- Gjendje ne arke 222,399 lek

Gjendjet e parave ne banka eshte e njejte me konfermat bankare perkatese ne fund te vitit 2021. Gjendja e parave ne arke eshte pa ndryshime me ate sipas inventarizimit te saj me 31.12.2021.

ii.- Aktive te tjera afatshkurtera

Kerkesa te arketueshme per mallra e sherbime te shitura 60,574,873 lek. Jane deklaruar me vleften e mundshme te arketimit te tyre.

Kerkesa te tjera afatshkurtera 0 lek perbehen nga te drejta te tjera te arketueshme ndaj te treteve.

iii. Iventaret

Me 31.12.2021 shoqeria ka gjendje te inventarit te mallrave per rishitje ne magazine

Mallra 0 lek

iv. Investime

Me date 31.12.2021 shoqeria ka investime të mbartur nga viti i mëparshëm ne vleren 301,800 lek ne te cilen eshte pjesemarese ne kapital ne shoqerine koncensionare Z.M.A ne perqindje jo-kontrolluese.

B1.2 - Aktivet afatgjata materiale

i.- Aktivet materiale

Gjendja e aktiveve afatgjata materiale per vitin 2021, vleresuar me vleren neto eshte si vijon :

- Toka dhe ndërtesa 30,736,832 Lek
- Impiante dhe makineri 5,229,987 Lek
- Të tjera Instalime dhe pajisje 2,363,933 Lek

Keto aktive jane inventarizuar me 31.12.2021. Ato ekzistojne, jane vleresuar drejte, dhe deklarohen ne menyre korrekte me vleren e mbetur.

ii.- Aktivet afatgjata jomateriale

Shoqëria nuk ka gjendje të aktiveve afatgjata jomateriale

B2. - PASIVET

B2.1.- Detyrimet afatshkurtra

i.- Huamarrjet afatshkurtera

Shoqëria nuk ka marrë hua afatshkurtera gjatë vitit 2021 për të fuqizuar aktivitetin tregëtar dhe me 31.12.2021.

ii. Huatë dhe parapagimet

- Te pagueshme ndaj furnitoreve. 18,137,019 leke
- Te pagueshme ndaj punonjësve (sigurime shoqërore, shendetesore, TAP dhe paga) 1,417,895 lek të pa paguara. Këto detyrime janë krijuar në Dhjetor 2021 për sigurimet dhe janë shlyer rregullisht pas mbylljes së ushtrimit sigurime shoqërore dhe TAP vitit 2021.
- Detyrime të pagueshme për leasing të cilat do të mbyllen në vitin në vazhdim janë 0 lek
 - Te pagueshme për detyrime Tatimore 4,283,010 përbehet nga detyrime për TVSH dhe Tatim Fitimin.
 - Te pagueshme për detyrime të tjera është ndaj të tremeve është 7,284,027 Lek.

B2.2.- Detyrimet afatgjata

i.- Hua afatgjata

- - Totali i detyrimeve afatgjata është 3,390,068 lek, që përbehen nga detyrime të pagueshme për leasing të cilat do të mbyllen në vitet në vazhdim

B3.- Kapitali

- Kapitali i regjistruar me datën 31.12.2021 është 98,000,000 leke.

Shoqëria me vendim ortakut nr.55, datë 10.12.2021 ka vendosur shtojë kapitalin nga Rezultati Financiar dhe fitimet e mbartura si dhe të emërojë përfaqësues ligjor z. Edison Stojna me NIPT L51306072H, Auditues ligjor për përgatitjen e procedurave për Zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë.

Me vendim ortakut 76, datë 22.12.2021, Shoqëria miratoi Raportin e Auditetit Ligjor dhe zmadhimin e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë nga 33,000,000 Lek në 98,000,000 Lek.

- Kapitale të tjera të veta përbehen nga:

• Rezerva ligjore	5,051,375	Lek
• Fitimi (Humbja) e pashpërndarë	760,205	Lek
• Fitim / Humbja e Vitit ushtrimor	19,361,258	Lek

- **Totali i kapitalit** **123,172,839 Lek**

B4.- TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

i.-Te ardhurat e shoqërise janë në vlerën **61,084,713 Lek** perbehen nga :

- Te ardhur nga shitje mallrash **0 Lek**
- Te ardhura nga shitja e Shërbimeve **61,084,713 Lek**

Keto të ardhura përbehen nga shitje pa Tvsh që i takojnë procesit të rindërtimit në vlerën 22,297,930 Lek dhe të ardhura nga shitja me shkallë tatimore (TVSH) në vlerën 38,786,783 Lek.,

Të ardhura pa TVSH e deklaruar në sistemin tatimor janë në vlerën 24,048,930 është zbritur vlera 1,751,000 lek faturuar me faturë tatimore nr.54, datë 09.12.2021 që i takon subjektit Bashkisë Tiranë.

Fatura është anuluar më datë 24.01.2022 me nr 1, datë 24.01.2022 në po të njëjtën vlerë 1,751,000 Lek

ii.-Shpenzimet të periudhës Ushtrimore janë të justifikuar me dokumenta dhe të lidhura me veprimtarinë e shoqërise në vlerën **37, 908,913 Lek** të cilat përbëhen:

- **Shpenzime lëndë dhe materiale të konsumueshme në vlerën 24,051,705 lekë ku përfshihen:**

- blerje shërbime projekte, mbikqyerje e të tjera shërbime në funksion të aktivitetit në vlerën 19,723,412 Lek
- sigurime kontrate në vlerën 2,879,100 Lek
- shërbime ligjore, avokati dhe financiare në vlerën 2,879,100 Lek
- Shërbime të tjera dhe noterie në vlerën 1,036, 351 Lek.

- **Te tjera shpenzime në vlerën 4,526,207 Lek ku përfshihen:**

- shpenzime administrative në vlerën 967,849.60 Lek
- shpenzime për personelin në vlerën 2,275,607 Lek
- Taksa Vendore në vlerën 114,020 Lek
- shpenzime për makineri dhe pajisje në vlerën 815,255 Lek,
- shpenzime për gjoba, kamatë dhe interesa në vlerën 353,475 lekë

- Shpenzime për Paga dhe shpërblime në vlerën 5,365,341 Lek

- Shpenzime të sigurime Shoqërore 896,012 Lek

- Shpenzime Konsumi dhe amortizimi në vlerën 2,877,051 Lek.

- Shpenzime Interesi në vlerën 192,597 Lek.

iii.- REZULTATI FINANCIAR

Per vitin 2021 Shoqëria ka rezultuar me fitim përpara tatimit në vlerën **23,175,800 Lekë,**

Janë shtuar shpenzimet e pazbritshme për gjoba, kamata, interesa si dhe paga të pakaluar në sistemin bankar në vlerën **2,254,475 lekë** për llogaritjen e taatimit mbi fitimin.

Janë shtuar shpenzimet e pazbritshme për gjoba, kamata, interesa si dhe paga të pakaluar në sistemin bankar të cilat janë paguar me arke në vlerën 2,254,475 lekë për llogaritjen e taatimit mbi fitimin.

Shpenzime Tatim Fitimi janë në vlerën 3,814,541 Lek

Fitimi Neto I periudhës është në vlerën 19,361,258 Lek

C.-Shënime të tjera shpjeguese

i. Palet e Lidhura

Nuk ekzistojnë maredhenie me pale të lidhura.

ii.-Vijimesia

Veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijimësi dhe njësi ekonomike nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

iii.-Ngjarje pas dates së bilancit.

Ngjarjet e ndodhura pas dates së bilancit për të cilat behen rregullime apo ngjarjet e ndodhura pas dates së bilancit për të cilat nuk behen rregullime nuk ka.

Gabime material të ndodhura në periudhat kontabel të mëparshme të konstatuara gjatë Periudhës rraportuese dhe që korigjim nuk ka.

Tirane më 23.03.2022

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
STUDIO-KONTABEL
"ALB-ACCOUNTING"

Endrit Mansaku

Auditues Ligjor

Nr. Lic 448

Dt. 06.02.2021



Per Drejtimin e Njesise Ekonomike
ADMINISTRATOR

ARQILE PERI